



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Nr. 595/28
Data 17.06.2026

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI (ZRRE)

Mbështetur në Nenin 39 par. 1, 4 deri 15 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Nenit 6 të Ligjit Nr. 08/L-294 për plotësim ndryshimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, dispozitat e Nenit 8 par. 2, dhe Nenin 9 të Ligjit për Rregullatorin për Energji (Ligji Nr. 05/L-084), dispozitat e Nenit 5 të Rregullores (QRK) Nr. 07/2025 për Procedurën e pranimit në Shërbimin Civil, Nenin 10 të Rregullës për Organizimin dhe Funksonimin e Zyrës së Rregullatorit për Energji, Nenit 15 të Manualit të Operimeve të Zyrës së Rregullatorit për Energji, me datë 18 qershor 2026 shpall:

KONKURS

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Titulli i pozitës së punës	Analist për Monitorim të Tregut
Klasa e pozitës	Profesional 1
Koeficienti/Paga	6.75/890 Euro
Nr. i kërkuar	1
Kohëzgjatja e emërimit	Emërim me afat të pacaktuar
Data e njoftimit	18/06/2026
Afati për aplikim	19/06/2026 - 18/07/2026
Institucioni	Zyra e Rregullatorit për Energji e Republikës së Kosovës
Departamenti	Tregut të Energjisë
Divizioni	N/A
Vendi i Punës	Prishtinë
Nr. i Referencës	RN00019896
Kodi	RPC0013435

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

- Analisti për Monitorim të Tregut do t'i ndihmojë dhe raportojë udhëheqësit të Departamentit të Tregut të Energjisë, në monitorimin dhe zbatimin e obligimeve të licencuarve sipas kërkesave ligjore dhe akteve tjera që rregullojnë tregun e energjisë;
- Ai/ajo do të kontribuojë në kontrollimin dhe Analizon të dhënat e pranuar nga te licencuarit, lidhur me tregun e energjisë elektrike, duke përfshirë vlerësimin e kontratave të lidhura nga pjesëmarrësit e tregut dhe rezultatet ia prezanton udhëheqësit të departamentit, si dhe kryen sistemimin e dokumentacionit të shkëmbyer me çdo të licencuar që lidhet me fushën që ai/ajo e mbulon;
- Monitorimi i performances së licencuarve në mënyrë efektive dhe të reagojë ndaj ndjeshmërisë së tregut të ndërmarrjeve në kohë, transparente dhe të përgjegjshme;
- Ai/ajo bashkëpunon me udhëheqësin e Departamentit, departamentet tjera dhe menaxhmentin e ZRRE-së, lidhur me aspektet ekonomike dhe tarifore të çështjeve rregullative;
- Ai/ajo merr pjesë dhe ofron këshilla profesionale të bazuara nga përvoja në hartimin e legjislacionit primar dhe sekondar në lëminë e Energjisë Elektrike;
- Përgatit analiza, propozime dhe raporte të monitorimit;



- Ofron këshilla profesionale dhe bën udhëzime me rastin e kërkesave, ankesave që bëhen nga ndërmarrjet e energjisë, personat fizik dhe juridik duke u bazuar në Ligjin për Energjinë, Ligjin për Energjinë Elektrike, Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe kërkesave teknike të kodeve dhe rregulloreve që rrjedhin nga legjislacioni primar;
- Kryen detyra konkrete që kanë të bëjnë me realizimin dhe zbatimin e planeve të punës, dhe detyrat që i ngarkohen nga mbikëqyrësi dhe i raporton në vazhdimësi;
- Kryen detyra tjera të caktuara nga Udhëheqësi i Departamentit;

2. Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë, sipas nenit 9 të LZP-së

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës.
- Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- **a) Arsimimi i kërkuar:** Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) – Fusha (drejtimet) e Ekonomisë.
- **b) Kërkesat specifike:** NUK KËRKOHET
- **c) Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lire të punës.

4. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

- Njohuri të thella dhe të specializuara në fushën profesionale specifike;
- Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë;
- Njohuri të gjëra të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;
- Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës;
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar;
- Aftësi për të punuar me vetë iniciativë në kuadër të planeve dhe procedurave të përcaktuara;
- Shkathtësi të mira të komunikimit, përfshirë aftësinë për të dhënë udhëzime dhe përcjellë informata tek të tjerët;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point);
- Njohja e gjuhës angleze përparësi;



5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

- Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës.
- Kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës. Nëse diploma është fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar jashtë vendit apo aktin që dëshmon se diploma e fituar jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë;
- Kopjet e dëshmisë së punësimit(vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë. Dëshmisë e punësimit jashtë institucioneve publike duhet të mbështet së paku njëra nga dëshmitë si në vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale apo pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale. Përvoja e punës, e cila deklarohet sipas kushteve të konkursit, e fituar në një shtet tjetër, dëshmohet përmes dëshmisë së përkthyer mbi përvojën e punës së lëshuar nga organi kompetent i atij shteti, apo përmes dëshmisë së përkthyer dhe noterizuar të përvojës të lëshuar nga punëdhënësi përkatës.
- Dëshmitë e trajnimeve profesionale të ndjekura apo trajnimeve që aplikuesi i ka realizuar në cilësinë e trajnuesit.
- Kopjet e dokumenteve tjera që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.

Dëshmitë që nuk kërkohen gjatë aplikimit, por në fazën e verifikimit para emërimit

- Certifikatën mbi dënimet penale origjinale e lëshuar nga gjykata përmes së cilës dëshmohet se nuk është i/e dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje, jo më të vjetër se(6) muaj nga data e lëshimit.
- Dëshmia se kandidati nuk ka masë disiplinore në fuqi për shkelje të rëndë në institucion publik (kandidatët që janë të punësuar apo kanë qenë të punësuar në institucione publike).
- Dëshmi se kandidati është i aftë në pikëpamje shëndetësore.
- Dëshmi përkatëse se kandidati ka zotësi të plotë për të vepruar.

6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për pranim do të shpallet më së largu deri më datën 02/08/2026, në portalin e rekrutimit elektronik <https://konkursi.rks-gov.net> dhe email zyrtar.

7.Kriteret specifike shtesë

NUK APLIKOHEN



8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim – maksimumi 60 pikë
- Intervista – maksimumi 40 pikë

9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik <https://konkursi.rks-gov.net/jobs>

10. Mënyra e aplikimit

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik <https://konkursi.rks-gov.net/jobs>

11. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik <https://konkursi.rks-gov.net>, dhe emalit zyrtar. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Të dhëna shtesë:

Pas përzgjedhjes së kandidatit fitues, njësia përgjegjëse bën verifikimin para emërimit me qëllim të vërtetimit se kandidatët vazhdojnë të plotësojnë kriteret e konkursit, përmes dokumenteve ne origjinal apo të njësuara me origjinalin.

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në LZP.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.